



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

Nr. 564 .Prot.

Peqin, më 03/04/2023

VENDIM

Nr. 83, Datë 03.04.2023

**“PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE RREGULLAT PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe Udhëzimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Nr. 6, datë 23.03.2021 “Per perdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat per afishimin e tyre gjate fushates zgjedhore”;

**VENDOSA:**

1. Përcaktimin e kritereve për përdorimin e materialeve propagandistike/edukuese dhe përcaktimin e listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, në zbatim të Udhëzimit Nr. 6, datë 23.03.2021 “Per perdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat per afishimin e tyre gjate fushates zgjedhore”.
2. Materialet propagandistike zgjedhore lejohen të afishohen deri ne nje distance prej 5 (pese) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkates, jo me pare se 30 dite para datës së zgjedhjeve.
3. Vendi për vendosjen e materialeve edukuese, që do të afishohen nga palët e treta, që nuk kanë lidhje me subjektet zgjedhore është caktuar në cdo holl të zyrave të gjendjes civile të Bashkisë Peqin
4. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambientet rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative parqeve, ne pemet e qytetit dhe në shtyllat e ndricimit. Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik.
5. Secili subjekt zgjedhor pjesëmarres në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 do të pajiset me leje për afishimin e materialeve propagandistike, në momentin e njoftimit me shkrim pranë Bashkisë Peqin për hapjen e zyrave zgjedhore dhe adresat e sakta të tyre.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Policia Bashkiake, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

**KRYETARI I BASHKISË**

/ Lorenc TOSKU /





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

Nr. 3491/1 Prot.

Peqin, më 03/04/2023

Lënda: Shkresë përcjellëse

Drejtuar: KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.1033.prot., datë 21.2.2023 "Kujtesë për zbatimin e rregullave në kuadër të fushatës zgjedhore" bashkëngjitur po ju dërgojmë Vendimin nr. 83, datë 03.04.2023 të Kryetarit të Bashkisë Peqin "Për vendosjen e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

/ Lorenc TOSKU

